



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 114, datë 31.08.2020**

**PËR**

**MIRATIMIN E ZGJATJES SË AFATIT DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN  
NR. 119, DATË 06.06.2019 “MBI ADMINISTRIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT”**

Në bazë të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 46, pika 2, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e Transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Rregullores nr. 119, datë 06.06.2019 “Mbi administrimin e Fondit të Kompensimit”, për një periudhë tjetër 1-vjeçare.
2. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren nr. 119, datë 06.06.2019 “Mbi administrimin e Fondit të Kompensimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe departamentet përkatëse të Autoritetit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**

**Në Rregulloren nr. 119, datë 06.06.2019 “Mbi administrimin e fondit të kompensimit”, në nenin 4, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

**1. pas shkronjës “c”, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:**

“d. Dëme shëndetësore të pësuar nga pasagjerët apo drejtuesi i mjetit motorik të siguar, i dëmtuar në aksidentin e shkaktuar nga një mjet i paidentifikuar, dëmi i shkaktuar do të paguhet nga shoqëria e sigurimit ku mjete motorik është i siguar.”

**2. pas pikës 4.1/c, shtohet pika 4.1/d, me këtë përmbajtje:**

“4.1/d: Mjeti shkaktar i paidentifikuar dëmton drejtuesin dhe/ose pasagjerët që udhëtojnë në mjetin me targë YY000YY, i siguar pranë shoqërisë X. Shoqëria e sigurimit X bën dëmshpërblimin e palës së dëmtuar.”

**3. pika 4.1/a/b/c, ndryshon si vijon:**

“4.1/ a/b/c/d: Në rastin kur kemi dy ose më shumë mjete të dëmtuara të siguruara, dëmet materiale dhe/ose shëndetësore sipas pikave a), b), c) dhe d) më lart, trajtohen, paguhen dhe rimbursohen nga shoqëria siguroese e secilit mjet të dëmtuar.”